

A INJHNI TË DREJTAT TUAJA?

Qëndrimi në paraburgim mund të jetë një përvojë jashtëzakonisht e frikshme. Është e rëndësishme që të njihni të drejtat tuaja gjatë kohës që jeni në paraburgim.

KËSHILLA LIGJORE FALAS

Kjo duhet t'ju ofrohet përpara se të merreni në pyetje në stacionin e policisë. Ju mund të kërkonti "avokatin falas të caktuar nga shteti" në stacionin e policisë. Ata janë në dispozicion 24 orë në ditë dhe janë të pavarur nga policia. Ose mund të kërkonti me avokatin tuaj nëse keni një të tillë.

KUJDESI MJEKËSOR

Nëse jeni të lënduar ose nuk ndiheni mirë, ju keni të drejtën e kujdesit mjekësor.

VENDNDODHJA JUAJ

Ju mund t'i kërkonti policisë të informojë dikë, p.sh. një pjesëtar të familjes se ku jeni, diçka që ata duhet ta bëjnë.

NDIHMA GJUHËSORE

Ju mund të shfrytëzoni ndihmën e një përkthyesi, nëse keni nevojë.

LEXONI RREGULLAT E SHKRUARA

Ju keni të drejtën të lexoni rregullat që duhet të respektohen nga oficerët e policisë, të cilat njihen edhe si "Kodi i Sjelljes Profesionale". Ju gjithashtu mund të kërkonti të lexoni një 'njoftim' ose dokument të shkruar nga policia, që ju informon mbi të drejtat, si p.sh. të bëni pushime të rregullta për të ngrënë dhe të përdorni tualetin.



NDIHMË TJETËR

Nëse konstatohet se jeni një i rritur i rrezikuar, përpara arrestimit, ju keni të drejtën të keni të pranishëm dhe mbështetjen e një "të rrituri të përshtatshëm" – si njërin nga prindërit, një kujdestar të zakonshëm ose ligjor, një pjesëtar të familjes mbi 18 vjeç, një punonjës social ose një vullnetar në moshë madhore gjatë gjithë kohës së paraburgimit.

A MESSAGE FOR STAFF

Are you confident the young person can understand this text? If not, please scan the QR code so they can access an alternative version of this leaflet.



saferlondon

Safer London është një shoqatë bamirëse e regjistruar në Angli dhe Uells me nr. 1109444; dhe një shoqëri e kufizuar me garanci nr. 5190766. www.saferlondon.org.uk

A KENI NDONJË GJEST TË NDRYSHËM TË GJUHËS SË TRUPIT OSE NDONJË KOMUNIKIM NDRYSHE PËR TË CILIN DUHET T'I TREGONI NJË OFICERI?

Është e rëndësishme që të vini në dijeni oficerët për çdo nevojë komunikimi që keni. Kështu që ata mund të jenë të vetëdijshëm për mënyrën më të mirë të komunikimit me ju në një mënyrë që është e kuptueshme dhe e rehatshme për ju.

- ✎ A keni ndonjë nevojë mësimore si p.sh. nëse jeni me autizëm apo ADHD (Çrregullim i hiperaktivitetit dhe mungesës së vëmendjes)?
- ✎ A keni probleme me leximin?
- ✎ A nuk është anglishtja gjuha juaj amtare?
- ✎ A e keni të vështirë të komunikoni përmes kontaktit me sy?
- ✎ A keni probleme me dëgjimin dhe keni nevojë për një përkthyes të Gjuhës Britanike të Shenjave (BSL)?
- ✎ A vuani nga ankthi?

Nëse po, atëherë njoftoni një oficer ose përfaqësues ligjor sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që ai të mund t'ju kuptojë më mirë ju dhe nevojat tuaja.

SHFRYTËZIMI DHE TRAFIKIMI; MEKANIZIMI KOMBËTAR I REFERIMIT (NRM)

Ndonjëherë kur njerëzit cenohen nga të tjerët, ata mund të trafikohen.

Mekanizmi Kombëtar i Referimit (NRM) të trafikimit është procesi që identifikon viktimat e skllavërisë njerëzore ose moderne dhe siguron që ato të marrin mbështetjen që u nevojitet.

Me trafikim të qenieve njerëzore nënkuptojmë kur njerëzit detyrohen ose mashtrohen të punojnë, të kryejnë krime ose aktivitete seksuale kundër vullnetit të tyre, zakonisht për përfitimin e dikujt tjetër. Viktimat shpesh kontrollohen nga të tjerët dhe mund të jenë nën presion që të sjellin më shumë njerëz. Nëse e keni përjetuar këtë ose njihni dikë që e ka përjetuar, kontaktoni me një oficer, përfaqësuesin tuaj ligjor ose një profesionist të besuar, në mënyrë që ai të mund t'ju ofrojë ndihmën e duhur.

KONTAKTE TË NEVOJSHME

 Linja e ndihmës UK modern slavery & exploitation Helpline: 08000 121 700 (hapur 24 orë/7 ditë në javë)

 Linja e ndihmës National Domestic Abuse Helpline: 0808 2000 247 (hapur 24 orë/7 ditë në javë)

 Linja këshilluese mbi ligjin penal nga shoqata Rights of Women: 020 7251 8887 (Hapur të martave nga ora 10:00 deri në 12:00, të enjteve nga ora 19:00 deri në 21:00).

Shoqata mund t'ju këshillojë rreth krimeve seksuale, duke përfshirë përdhunimin dhe dhunën seksuale, dhunën në familje, ngacmimin dhe përndjekjen, denoncimin e krimeve në polici dhe sistemin e drejtësisë penale, duke përfshirë kompensimin si pasojë e lëndimeve kriminale.